



Broshura informuese për vlerësimin përshkrues dhe përmbledhës



Hartuan: Aurela Zisi dhe Irida Sina
Mbështetur nga Save the Children

GUSHT, 2014

Të dashur Mësues dhe Prindër,

Siç jeni vënë në dijeni, nxënësit e klasave të para, të dyta dhe të treta po vlerësohen me një mënyrë të re vlerësimi: sipas vlerësimit përshkrues dhe përmbledhës.

Si çdo risi që vjen në arsim, edhe për këtë proces lindin pyetje, të tilla si: *Çfarë rëndësie ka vlerësimi përshkrues për nxënësit e tri klasave të para? Ku mbështetet ai? Si kryhet vlerësimi përmbledhës? Pse është e rëndësishme hapja e dosjes për cdo nxënës? Si mund ta ndihmojmë fëmijën për ta organizuar më mirë dosjen e punimeve? Ç'domethënie ka secila shkallë vlerësimi? Si informohet prindi gjatë vitit shkollor për ecurinë e fëmijës së tij? Si hidhet në dëftesë vlerësimi përshkrues? Si plotësohet Amza e shkollës?* etj.

Pyetjet e mësipërme gjejnë përgjigje njëra pas tjetrës në faqet e kësaj broshure.

Për më tepër informacion në lidhje me vlerësimin përshkrues dhe përmbledhës drejtohuni pranë mësuesit të klasës, drejtorisë së shkollës ose faqes zyrtare të Institutit të Zhvillimit të Arsimit www.izha.edu.al.

Suksese dhe Punë të mbarë!

Përmbajtja e broshurës

- Si lindi nevoja për vlerësimin përshkrues të nxënësve të klasave I-III
- Rëndësia e vlerësimit përshkrues dhe përmbledhës
- Vlerësimi përshkrues
- Detaje shpjeguese për secilën shkallë vlerësimi
- Plotësimi i Regjistrit të klasës, i Dëftesës dhe i Amzës së shkollës
- Vlerësimi përshkrues sipas lëndëve mësimore
- Portofoli i nxënësit
- Komunikimi i rezultateve tek prindërit
- Orientime për prindërit për të ndihmuar fëmijët për të kaluar vështirësitë

SI LINDI NEVOJA PËR VLERËSIMIN PËRSHKRUES TË NXËNËSVE TË KLASAVE I-III TË CIKLIT FILLOR

Në arsimin fillor, përvojat mësimore i shërbejnë nxënësit të kalojë natyrshëm në një etapë të re të fëmijërisë së hershme, nga të mësuarit nëpërmjet lojës të mësimdhënies me nxënësin në qendër, të detyrat dhe angazhimet e reja që u dikton shkolla.

Procesi i të nxënësve përqendrohet në ngritjen e bazave të shëndosha për zhvillimin gjuhësor, fizik, njohës, social-emocional dhe përfaqësues ndaj të nxënësve. Gjatë viteve të para të shkollës, kujdes i veçantë i kushtohet zhvillimit të personalitetit të fëmijës dhe qëndrimit pozitiv ndaj të nxënësve, si bazë për zhvillimin e kompetencës kyçe “Të mësuarit për të nxënësve”.

Vlerësimi përshkrues shërben për të vlerësuar arritjet e nxënësve dhe drejtimit ku nxënësit kanë nevojë për ndihmë e mbështetje në mënyrë që të kapërcejnë vështirësitë në të nxënësve.

RËNDËSIA E VLERËSIMIT PËRSHKRUES DHE PËRMBLEDHËS

Vlerësimi realizohet nëpërmjet përdorimit të instrumenteve dhe të procedurave të ndryshme të mbledhjes së të dhënave, interpretimit dhe analizës së tyre në dobi të përmirësimit të mësimdhënies dhe të të nxënësve.

Nëpërmjet vlerësimit të arritjeve dhe zhvillimit individual, evidentohen anët dhe pikat e forta, si dhe drejtimit të cilat çdo nxënës ka nevojë për ndihmë, mbështetje dhe motivim.

Njohja më e mirë e nxënësve dhe e arritjeve të tyre e ndihmon mësuesin dhe prindin të punojnë më tepër në ato drejtime, të cilat pengojnë ecurinë dhe përparimin e tyre të mëtejshëm.

Kohë pas kohe, gjykimi për atë çfarë arrin nxënësi sinjalizon të rriturin si po lëviz trajektorja e progresit të tyre.

Praktika e deritanishme e vlerësimit të nxënësve ka qenë e tillë:

- Në klasat e para dhe të dyta, nxënësit janë vlerësuar me shprehje në katër shkallë vlerësimi “Dobët”, “Mjaftueshëm”, “Mirë”, “Shumë mirë”.

- Në klasën e tretë dhe më tej vlerësimi i nxënësit është bërë me nota, nga 4-10.

Me daljen e Dispozitave të reja Normative, 2013, vlerësimi i nxënësve nga klasa e parë në të tretë bëhet nëpërmjet vlerësimit përshkrues dhe përmbledhës. Neni 15, Pika 5, përcakton se *“Mësuesi vlerëson nxënësit me përshkrim: gjatë vitit mësimor, në përfundim të disa periudhave të vitit mësimor dhe në fund të vitit mësimor, për: a) qëndrimin dhe aftësitë e përgjithshme të fëmijës si nxënës; b) për objektivat kryesore në fushat e të nxënit. Periudhat caktohen nga ministri. Mësuesi kryen vlerësimet sipas formatit që hartohet nga IZha dhe miratohet nga ministri”*.

VLERËSIMI PËRSHKRUES

Vlerësimi përshkrues ka si qëllim të evidentojë anat e forta, dobësitë dhe vështirësitë konkrete që ka secili nxënës në çdo linjë të programeve lëndore. Në kurrikulën aktuale¹ që zbatohen në shkollat tona, programet lëndore janë të ndërtuara me linja, ku secila prej tyre zë një peshë/përqindje të caktuar, e shprehur në sasi të caktuara orësh. Nxënësi vlerësohet për arritjet e tij në secilën prej linjave nga fillimi i vitit shkollor deri në përfundim të tij, duke marrë në konsideratë përmbushjen e objektivave specifikë.

Neni 15, Pika 5, përcakton se *“Mësuesi vlerëson nxënësit me përshkrim: gjatë vitit mësimor, në përfundim të disa periudhave të vitit mësimor dhe në fund të vitit mësimor, për: a) qëndrimin dhe aftësitë e përgjithshme të fëmijës si nxënës; b) për objektivat kryesore në fushat e të nxënit. Periudhat caktohen nga ministri. Mësuesi kryen vlerësimet sipas formatit që hartohet nga IZha dhe miratohet nga ministri”*.

Mbështetur në këtë Nen, u përcaktua që vlerësimi përshkrues i nxënësit të realizohet në periudha tremujore, tri herë në vit, të cilat përfaqësojnë bien në muajt dhjetor, mars dhe qershor (në varësi të fillimit dhe përfundimit të vitit shkollor).

Vlerësimi përmbledhës realizohet një herë në vit, pas realizimit të vlerësimit të tretë përshkrues.

¹ Duke filluar nga viti akademik 2014-2015, në 26 shkolla pilot të arsimit bazë, pranë Drejtorive Arsimore Rajonale, ka nisur pilotimi i kurrikulës së re. Kurrikula e re është e ndërtuar mbi bazën e kompetencave kyçe dhe kompetencave të fushës. Vlerësimi i nxënësve nga klasa e parë në të tretë do të bëhet duke u mbështetur në përmbushjen e këtyre kompetencave.

Vlerësimi përshkrues *realizohet me 5 nivele/ shkallë*² dhe bazohet në shpjegimet e mëposhtme³:

Shkalla 1. “*Arritje të pakënaqshme*” do të konsiderohen kur nxënësi nuk përmbush asnjë nga objektivat bazë të të nxënës (kjo përkon me vlerësimin “Dobët” ose me notën 4).

Shkalla 2. “*Arritje që kanë nevojë për përmirësim*” do të thotë që nxënësi ka arritur vetëm pak nga objektivat bazë të të nxënës dhe kërkohet mbështetje dhe punë e vazhdueshme nga ana e mësuesit (kjo përkon me vlerësimin “Mjaftueshëm” ose me notat 5 dhe 6).

Shkalla 3. “*Arritje të kënaqshme*” do të konsiderohen kur nxënësi ka përmbushur objektivat mesatare të të nxënës dhe, kur me mbështetjen e mësuesit, arrin të përparojë (kjo përkon me vlerësimin “Mirë” ose me notën 7).

Shkalla 4. “*Arritje shumë të kënaqshme*” do të konsiderohen kur nxënësi ka përmbushur pjesën më të madhe të objektivave të të nxënës (kjo përkon me vlerësimin “Shumë mirë” ose me notat 8 dhe 9).

Shkalla 5. “*Arritje të shkëlqyera*” do të konsiderohen kur fëmija përmbush plotësisht objektivat e të nxënës të programit lëndor (kjo përkon me vlerësimin “Shkëlqyeshëm” ose me notën 10).

DETAJE SHPJEGUESE PËR SECILËN SHKALLË VLERËSIMI

Nxënësi që paraqet arritje të pakënaqshme (shkalla 1)

- Plotëson pak detyra.
- Ka nevojë të kujtohet shpesh për të bërë detyrat dhe është rrallë herë i motivuar.

² Kodet e shprehura me numra, nga 1 deri në 5 korrespondojnë me shkallët e vlerësimit përshkrues vendosen në regjistër.

³ Për secilën shkallë vlerësimi jepen emërtimet e niveleve të deritanishme të vlerësimit të nxënësve në klasat I-II dhe notat që përkojnë me secilën shkallë. Kjo bëhet që mësuesi dhe prindi të kuptojnë mënyrën e re të vlerësimit përshkrues, si dhe nivelin e përvetësimi të njohurive nga nxënësi/ fëmija.

- Detyrat i mungojnë, janë të paplotësuara, të pasakta dhe mund t'i dorëzojë me vonesë.
- Rrallë dëgjon me vëmendje, merr pjesë në diskutimet në klasë dhe në bashkëpunim me shokët.

Nxënësi që paraqet arritje që kanë nevojë për përmirësim (shkalla 2)

- Është i motivuar për të plotësuar detyrat, megjithatë disa prej tyre mund të mos zhvillohen plotësisht.
- Herë pas here duhet kujtuar që të bëjë detyrat.
- Ndonjëherë dëgjon me vëmendje dhe merr pjesë në aktivitete dhe diskutime në klasë dhe punon bashkërisht në grupe.

Nxënësi që paraqet arritje të kënaqshme (shkalla 3)

- Zakonisht është i motivuar dhe i përqendruar në detyra.
- I plotëson detyrat në kohë.
- Zakonisht dëgjon me vëmendje, merr pjesë në diskutim dhe në aktivitetet e klasës dhe punon bashkërisht në grupe.

Nxënësi që paraqet arritje shumë të kënaqshme (shkalla 4)

- I vetë-motivuar.
- I plotëson detyrat me kënaqësi.
- Shpesh kërkon dhe vihet përpara sfidave.
- Thuajse gjithmonë dëgjon me vëmendje, merr pjesë në diskutim dhe në aktivitetet e klasës dhe punon bashkërisht në grupe.

Nxënësi që paraqet arritje të shkëlqyera (shkalla 5)

- Është i vetëdrejtuar.
- Kërkon sfida.
- Plotëson detyrat me entuziazëm.
- Dëgjon me vëmendje.



- Merr pjesë me entuziazëm në diskutim dhe në aktivitetet e klasës.
- Kontribuon në ndërveprimin efektiv të grupeve bashkëvepruese.
- Merr përgjegjësi për të zgjeruar rritjen personale dhe akademike

PLOTËSIMI I REGJISTRIT TË KLASËS, I DËFTESËS DHE I AMZËS SË SHKOLLËS

Duke filluar nga vitit shkollor 2014-2015, regjistrat e klasave I-III janë përshtatur sipas mënyrës së re të vlerësimit. *Çdo ditë*, mësuesi hedh në regjistër datën, temën e mësimit dhe mungesat e nxënësve.

Në fund të çdo tremujori, në regjistër plotësohet vlerësimi përshkrues i nxënësve, i cili bëhet për çdo linjë të programit lëndor, në kolonat përkatëse. Në regjistër, vlerësimi bëhet me kode nga 1-5 në ato linja, orët e të cilave nuk janë zhvilluar ende, mësuesi në fund të faqes së regjistrit bën shënimin “Orët që i përkasin kësaj linje nuk janë zhvilluar ende.

Një herë në tre muaj, mësuesi i jep prindit informacion me shkrim për përparimin e fëmijës për çdo lëndë, por jo vetëm. Në vlerësimin përshkrues duhet të bëhet edhe një përshkrim i cilësive individuale të nxënësit, të aftësive bashkëpunuese dhe bashkëvepruese me nxënësit e tjerë në realizimin e detyrave dhe punimeve të përbashkëta.

Në fund të vitit shkollor bëhet vlerësimi përmbledhës, i cili përcakton nivelin e arritjeve akademike të secilit nxënës, po sipas linjave të programeve lëndore.

Në dëftesë bëhet vlerësimi vjetor i arritjeve të nxënësit, i shprehur me emërtimin e plotë të shkallëve të vlerësimit, ku për secilën lëndë nxënësi merr njërin prej vlerësimeve: “Arritje të pakënaqshme”; “Arritje që kanë nevojë për përmirësim”, “Arritje të kënaqshme”; “Arritje shumë të kënaqshme” dhe “Arritje të shkëlqyera”.

Në Amzën e shkollës, vlerësimi bëhet me shkurtime të emërtimeve të shkallëve të vlerësimit, ku për: “Arritje të pakënaqshme” shkruhet APK ; për “Arritje që kanë nevojë për përmirësim” shkruhet ANP, “Arritje të kënaqshme” shkruhet AK; “Arritje shumë të kënaqshme” shkruhet AShK dhe “Arritje të shkëlqyera” shkruhet ASH.

VLERËSIMI PËRSHKRUES SIPAS LËNDËVE MËSIMORE⁴

Lënda: Gjuhë shqipe (Klasa I-III)

⁴ Bëhet fjalë për programet e kurrikulës ekzistuese.

	Klasa I	Klasa II	Klasa III
Sasia e orëve vjetore	280	280	210
Sasia e orëve për çdo tremujor	± 93	± 93	± 70

Nxënësi merr vlerësim për secilën nga linjat:

- Të dëgjuarit;
- Të folurit;
- Të lexuarit;
- Të shkruarit;
- Njohuri rreth sistemit gjuhësor.

Lënda: Gjuhë e huaj (Klasa III)

	Klasa I	Klasa II	Klasa III
Sasia e orëve vjetore	-	-	70
Sasia e orëve për çdo tremujor	-	-	± 23-24

Nxënësi merr vlerësim për secilën nga linjat:

- Të dëgjuarit;
- Të folurit;
- Të lexuarit;
- Të shkruarit

Lënda: Matematikë (Klasa I-III)

	Klasa I	Klasa II	Klasa III
Sasia e orëve vjetore	175	175	175
Sasia e orëve për çdo tremujor	± 58-59	± 58-59	± 58-59

Nxënësi merr vlerësim për secilën nga linjat:

- Numri;
- Matja;
- Gjeometria;
- Algjebra dhe funksioni;
- Mbledhja, organizimi dhe përpunimi i të dhënave; probabiliteti

Lënda: Dituri natyre (Klasa III)

	Klasa I	Klasa II	Klasa III
Sasia e orëve vjetore	-	-	70
Sasia e orëve për çdo tremujor	-	-	± 23-24

Nxënësi merr vlerësim për secilën nga linjat:

- Lëndët dhe vetitë e tyre;
- Mjedisi fizik;
- Gjallesat dhe proceset e jetës

Lënda: Edukatë shoqërore⁵ (Klasa I-III)

	Klasa I	Klasa II	Klasa III
Sasia e orëve vjetore	35	35	35
Sasia e orëve për çdo tremujor	± 11-12	± 11-12	± 11-12

Nxënësi merr vlerësim për linjat:

- Individit dhe grupit;
- Komunikimi në shoqëri;
- Rregullat;
- Shërbimet në komunitet;

⁵ Programi lëndës së Edukatës shoqërore nga kalsa I-III, ka ndryshim në emërtimet e linjave, por përmbajtja e tyre mbetet brenda linjave të dhëna.

- Rruga;
- Shëndeti dhe Mjedisi;
- Prodhimi dhe Shpërndarja

Lënda: Edukim figurativ (Klasa I-III)

	Klasa I	Klasa II	Klasa III
Sasia e orëve vjetore	35	35	35
Sasia e orëve për çdo tremujor	± 11-12	± 11-12	± 11-12

Nxënësi merr vlerësim për secilën nga linjat:

- Baza materiale, procese e teknika;
- Elemente dhe parime;
- Tematika;
- Histori dhe kulturë;
- Analiza, interpretimi, vlerësimi;
- Lidhjet ndërlëndore dhe me mjedisin

Lënda: Edukim muzikor (Klasa I-III)

	Klasa I	Klasa II	Klasa III
Sasia e orëve vjetore	35	35	35
Sasia e orëve për çdo tremujor	± 11-12	± 11-12	± 11-12

Nxënësi merr vlerësim për secilën nga linjat:

- Këndimi;
- Bazat e arsimimit muzikor;
- Luajtja në instrument;
- Dëgjimi muzikor;
- Të shprehurit dhe krijimi muzikor

Lënda: Aftësim teknologjik (Klasa I-III)

	Klasa I	Klasa II	Klasa III
Sasia e orëve vjetore	35	35	35
Sasia e orëve për çdo tremujor	± 11-12	± 11-12	± 11-12

Nxënësi merr vlerësim për secilën nga linjat:

- Njeriu dhe shoqëria në teknologji;
- Teknologjia e materialeve dhe proceseve;
- Strukturat, mekanizmat, forcat dhe energjia;
- Teknologjia e informacionit dhe komunikimit

Lënda: Edukim fizik (Klasa I-III)

	Klasa I	Klasa II	Klasa III
Sasia e orëve vjetore	105	105	105
Sasia e orëve për çdo tremujor	± 35	± 35	± 35

Nxënësi merr vlerësim për secilën nga linjat:

- Njohuri të edukimit fizik;
- Aftësi lëvizore bazë;
- Manipulim lëvizjesh;
- Lojëra lëvizore;
- Lëvizje të thjeshta ritmike

PORTOFOLI I NXËNËSIT

Kur nxënësit arrijnë të vetëvlerësojnë punën dhe të nxënësit e tyre, themi se kemi arritur të realizojmë një mësimdhënie efektive. Duke kthyer kokën mbrapa në proceset që kemi kryer,

duke analizuar me kujdes atë që ka ndodhur, nxënësit fitojnë kuptime dhe ide të reja rreth vetes së tyre si persona që nxënë. Duke e parë punën e tyre në raport me të tjerët, ata do të mësojnë si të përmirësojnë më tepër punën e tyre, si të fitojnë njohuri, shprehi dhe shkathësi të reja.

Vetëvlerësimi dhe vetëreflektimi nuk kryhen në fund të kapitullit, të gruptemave apo pas marrjes së disa notave. Ato janë procese që ndodhin në mënyrë të vazhdueshme. Siç theksojnë Zessoules & Gardner (1991) nxënësit duhen mësuar si t'i fitojnë dhe t'i zhvillojnë "*aftësitë reflektuese të mendjes*".

Prandaj, mbajtja e portofolit është mënyra më e mirë për ta bërë këtë.

Mënyrat tradicionale të dhënies së listës të notave, të marra brenda një muaji, dëftesat dhe notat e fundit të vitit shkollor etj., prirën të zbulojnë se nxënësi ka dobësi, por jo se ku i ka konkretisht dhe cilat janë shkaqet e tyre.

Punimet dhe detyrat e futura në portofol janë mjete të fuqishme që i ndihmojnë nxënësit të zbulojnë anët e forta, dobësitë, mangësitë, vështirësitë dhe problemet që hasin gjatë procesit të punës, si dhe ofrojnë alrimi mundësish për t'u përmirësuar. Ato dëshmojnë përparimin e nxënësve, aftësitë dhe mundësitë, si dhe nivelin e arritur.

Mbajtja e portofolit personal dhe grumbullimi i materialeve është një mundësi e mirë edhe për prindërit për të njohur realisht se cili është fëmija e tyre, si nxë, sa dhe deri ku është në gjendje të përparojë, të dinë se deri ku mund t'u kërkojnë fëmijëve të tyre, ku duhet të punojnë e t'i ndihmojnë më tej. Ky proces nis që në fillim të vitit shkollor, kur vendosen punimet e nxënësve, shënimet dhe vlerësimet e mësuesit dhe komentet e prindërve.

Portofoli i nxënësit nuk është thjesht një koleksion ose mbledhjesh punimesh të rastësishme, por është një koleksion i qëllimshëm i punës së nxënësve, që tregon përpjekjet, arritjet, përparimin në një ose disa fusha apo lëndë. Zhvillimi dhe formimi i tyre nuk shfaqet vetëm në produktet përfundimtare. Ai është proces në vazhdim, që pasurohet çdo ditë.

Analiza dhe vlerësimi i punimeve të futura në portofol shërbejnë si nyje ndërmjet procesit të mësimdhënies, të nxënësve dhe reflektimit të mësuesit dhe nxënësve.

Rishikimi i dosjes së detyrave dhe punimeve bëhet në periudha afatshkurtra, kurse vlerësimi i saj bëhet në periudha më aftagjata, si p.sh: në fund të çdo tremujori, në fund të vitit shkollor, në fund të shkallës së kurrikulës ose në fund të një cikli shkollimi.

Vlerësimi përshkrues bazohet në analizën e plotë dhe të kujdesshme të punimeve me shkrim që janë futur në dosjen e nxënësit, në përgjigjet që jep me gojë, si dhe në pjesëmarrjen e tij në veprimtari të ndryshme që zhvillohen në shkollë.

Pjesë e vlerësimeve janë edhe përgjigjet me gojë që jep nxënësit. Në këto përgjigje, nxënësi vlerësohet për mënyrën si shprehet, te qartësia e prezantimit, te të shprehurit me intonacionin e duhur, te shqiptimi i saktë i fjalëve, te përgjigjet që japin ndaj pyetjeve që i bëhen, te interpretimet që bëhen, te besimi te vetja për mendimet që shfaq etj.

Nga klasa e aprë në të tretë, në portofol futen detyra shtëpie dhe klase që kanë lidhje me konceptet kryesore të trajtuara gjatë secilës periudhë tremujore, punime individuale që fëmijët i bëjnë në kohën e lirë, punime tematike, projekte kurrikulare ose module mësimore të kryera në orët e lira, kërkime individuale, skeda, vëzhgime, fisha vetëvlerësimi, opinione dhe mendime të nxënësve për punët e përbashkëta në grup, reflektime individuale të nxënësve, teste, detyra kontrolli nga drejtoria e shkollës apo DAR/ZA-ja, që dëshmojnë përparimin e nxënësit në periudhat të ndryshme të vitit shkollor.

Në vlerësimin përshkrues që i bëhet nxënësit, raportet ndërmjet llojeve të ndryshme të punimeve janë si më poshtë:

- a) Detyrat e shtëpisë zënë rreth 15% të vlerësimit;
- b) Detyrat e klasës dhe përgjigjet me gojë zënë rreth 30% të vlerësimit;
- c) Punimet individuale, punimet tematike, projektet dhe modulet e zhvilluara në mënyrë individuale ose në grup zënë rreth 25 % të vlerësimit;
- d) Testet dhe detyrat e kontrollit zënë rreth 30 % të vlerësimit.

Pra, siç duket edhe nga rubrikat e mësipërme, punimet që futen në portofol janë të larmishme dhe i japin mundësi çdo nxënësi të shfaqë dhe të tregojë çfarë di dhe çfarë është në gjendje të bëjë. Ato përshtaten me natyrën e lëndëve nga klasa I-III dhe me kërkesat e programeve.

Përqindjet ndërmjet rubrikave janë parë të arsyeshme duke u nisur nga mosha e fëmijëve, mundësitë reale që ata kanë, si dhe nga ndihma që përfitojnë nga prindërit në shtëpi.

Mësuesi mban shënime personale në lidhje me ecurinë dhe përparimin e vijueshëm të nxënësit, në mënyrë që vlerësimet përshkruese dhe përmbledhëse të jenë objektive dhe të sakta.

Lind pyetja: *Si mund ta bëjmë procesin e krijimit të portofolit sa më natyral dhe të këndshëm edhe për nxënësit?* Kushtet që duhen plotësuar janë:

- T'u krijohet mundësi nxënësve për të reflektuar për punën e bërë;
- Përzgjedhja dhe përdorimi i atyre metodave që mund të shfrytëzohen edhe nga nxënësit në kryerjen e detyrave të përditshme;
- Krijimi i mundësive për të bërë reflektime dhe vetëvlerësime: modele, formate e shembuj të vetëvlerësimeve, dhënia e herë pas hershme e dosjeve për t'u kontrolluar, përmirësuar e pasuruar etj.;
- Dhënia e mendimeve dhe e vlerësimeve të mësuesit për ato që kuptohen nga puna e nxënësve apo nga mendimet e shfaqura. Sugjerime për drejtimet ku mund të përmirësohet puna e nxënësve etj.

Përfitimet nga mbajtja e dosjeve personale dhe dokumentimi i përparimit të secilit nxënës dhe i sjelljes së tyre janë të shumta.

- *Për mësuesin*, përmbajtja e portofoleve tregon thellësinë, gjerësinë dhe shkallën e të kuptuarit të njohurive të nxënësve. Brenda secilës dosje gjenden pjesë e histori të ndryshme të nxëni. Mësuesi njih cilat janë prirjet, interesat, anët e forta, dobësitë, mangësitë dhe nevojat e nxënësve.
- *Për nxënësin*, japin një panoramë të përgjithshme të punës së tyre. Punimet e tyre pasqyrojnë përkushtimin e nxënësve, përpjekjet e bëra, rezultatet e arritura, vështirësitë që i kanë dalë, kontributin në punën në grup etj. Pra arritjet e tij. Detyrat e kryera u japin mundësi nxënësve të reflektojnë në punën e bërë dhe të përmirësohen në periudhën në vazhdim. Nxënësit fitojnë edhe aftësi estetike për rregullimin dhe sistemimin e materialeve. Ndërgjegjësohen për përparimin e tyre. Njohin më mirë veten e tyre edhe në aspekte ndoshta të pazbuluara më parë.

- *Për drejtuesit e shkollës, portofolet sigurojnë evidenca konkrete për ecurinë e çdo nxënësi. Ato provojnë nëse një dukuri e papritur, një bllokim apo vështirësi që i ndodh nxënësit është e rastësishme apo jo.*
- *Për prindërit, japin një spektër të plotë të formimit, zhvillimit dhe aftësive të fëmijëve. Prindërit shohin të dokumentuar çfarë dhe si nxënë fëmijët e tyre, cilat janë boshllëqet, cilat janë anët e forta, cili është mendimi i mësuesit, vlerësimi i tij dhe vetëvlerësimi i fëmijës. Kjo dëshmon se si fëmijët e shohin veten e tyre si njerëz që përpiqen, mësojnë, bien, ngrihen, përmirësohen, qëndrojnë në vend, pra si u ndodh ndryshimi dhe si përballen me të.*

Fazat e krijimit të portofolit të nxënësit

1. Vendosja e kriterëve

Para se të nisë ky proces duhen hartuar dhe vendosur cilat do të jenë kriteret e krijimit dhe të vlerësimit të dosjeve. Këto kriterë duhen diskutuar me nxënësit dhe prindërit, në mënyrë që të dihet nga secila palë se cilat janë qëllimet, formati dhe përmbajtja e dosjeve, çfarë pritet dhe ku duhet të përqëndrohet puna e përbashkët në të ardhmen. Kur këto kriterë do të diskutohen me prindërit sugjerohet që mësuesi të mbajë parasysh çështjet e mëposhtme:

- *Çfarë pret nga puna e nxënësve dhe ndihma e prindërve;*
- *Cilat janë synimet e tij për punimet e materialet që mbledh nga nxënësit;*
- *Cilat mund të jenë vështirësitë për mësuesin dhe për prindërit;*
- *Sa ndikon përditësimi i punimeve të portofolit në përparimin e fëmijës etj.*

2. Organizimi i përmbajtjes së portofolit

Pas hartimit të kriterëve, nis puna për hapjen, organizimin dhe sistemimin e portofolit. Është mirë që nxënësve t'u jepet një format se si mund të organizohen punimet. Këtë rregull nxënësit mund ta ndjekin ose jo. Përveç tabelës së përmbajtjes, e cila pasurohet vazhdimisht, në dosje duhet futur një *autobiografi* e shkurtër, ku nxënësi bën një përshkrim të dëshirave, interesave e prirjeve të tij. Përsa i takon llojeve të punimeve që mund të përfshihen në dosje mund të sugjeronim që në të të përfshiheshin:

- *Shembuj detyrash, të zhvilluara në shtëpi dhe në klasë. Këto detyra mund të jenë punë individuale, në grup ose të kryera në lëndë të ndryshme.*
- *Krijime të ndryshme artistike me letër, plastelinë, punëdore, copë etj.*

- *Punime* të lëndëve të ndryshme, të bëra në fletore, fleta, krijime, vizatime, përshkrime etj. Edhe këto punime mund të jenë pjesë e punës individuale ose të punës në grup.
- *Regjistrime* të ndryshme në kaseta dhe fotografi të bëra në mjedise e procese të ndryshme pune, në kohën e lirë, në zhvillimin e një veprimtarie jashtëshkollore, në ekskursione etj.
- *Punë me kompjuter*, të cilat demostrojnë aftësitë dhe shkathtësitë e nxënësit në kompjuter. Mund të jenë shkrime, vizatime, shfrytëzimi i programeve të ndryshme të kompjuterit etj.
- *Pjesëmarrja* në veprimtari të ndryshme brenda dhe jashtë shkollës, në të cilat nxënësi ka marrë pjesë, është vlerësuar, ka marrë çmim ose certifikatë pjesëmarrjeje ose vlerësimi etj.
- *Shkrime* të natyrave të ndryshme, për tema të dhëna ose të lira, të zhvilluara në shkollë, në shtëpi, përshtypje, mbresa, kujtime etj.
- *Shënime e komente* nga prindërit, mësuesja, shokët dhe vetë ai për veprimtari e kontribute të ndryshme.
- *Përmbledhje të librave të lexuar*, ku mund të shënohet titulli i librit, autori, mbresat që i ka lënë leximi i librit, komente në lidhje me pjesë të ndryshme libri, për veprimet e personazheve, mesazhin etj. Kjo procedurë mund të ndiqet edhe për librat e tjerë.
- *Zgjidhje të ushtrimeve dhe problemeve* të vështira, të cilat nxënësi i ka marrë nga teksti i nxënësit, nga libra të tjerë jashtëshkollore ose mund të jenë mënyra të tjera që ka përdorur për t'i zgjidhur.
- *Modele metodash dhe teknikash* të zbatuara për kryerjen e ushtrimeve, problemeve, detyrave të ndryshme, që kanë apo jo lidhje me detyrat e shkollës.
- *Formate vlerësimi dhe vetëvlerësimi*, të plotësuara nga mësuesi apo raste kur nxënësi ka bërë vetëvlerësimin e një pune të tij. Këtu përfshihen edhe testet e zhvilluara në shkollë ose në shtëpi, të cilat janë të vlerësuara, ose kanë komente e shënime nga mësuesi, shokët dhe prindërit.

Kësaj liste të materialeve të përmendura më sipër secili mësues mund t'i shtojë informacione të reja ose t'i heqë ato që i duken të paarritshme për nivelin e nxënësve të klasës së tij.

3. Rishikimi dhe vlerësimi i dosjeve

Pas mbushjes së dosjes me materiale të ndryshme, në periudha të caktuara kohe nxënësve u kërkohet t'i rishikojnë dosjet dhe të shkruajnë komente ose përmbledhje të shkurtra për to.

(Çfarë kanë bërë mirë, për çfarë kanë punuar gjatë një afati të caktuar kohor, ç'plane kanë bërë për të ardhmen etj.).

Për rishikimin dhe kontrollimin e dosjeve duhet vendosur një kohë, e cila duhet respektuar nga të gjithë nxënësit. Rishikimi mund të bëhet në mënyrë individuale, në çifte ose në grupe të vogla prej 4-5 nxënësish. Koha mund të variojë nga 1-3 herë për çdo tremujor.

Për vlerësimin e punimeve të portofolit duhen përcaktuar kritere, të cilat duhet të njihen nga të gjithë nxënësit. Ata vlerësohen:

- *Për cilësinë e materialeve dhe të punimeve;*
- *Për seriozitetin e përgatitjes së portofolit;*
- *Për gjetjet origjinale;*
- *Për aftësinë për të rishikuar, shkruar dhe eksperimentuar në mënyra të ndryshme;*
- *Për aftësinë për të shfrytëzuar burime të ndryshme informacioni;*
- *Për aftësinë për të mbrojtur punën e bërë;*
- *Për aftësinë për të mësuar gjëra të reja;*
- *Për aftësinë për të bërë vetëvlerësim, vlerësimin e punës së shokëve etj.*

Në procesin e vlerësimit zë një vend të rëndësishëm të mësuarit e nxënësve si të vetëvlerësojnë punën që kanë bërë. Në varësi të moshës dhe mundësive të tyre nxënësit mund ta bëjnë vetëvlerësimin në dy mënyra:

1. Shkrimi i një paragrafi të shkurtër vetëvlerësimi për çdo punim, duke theksuar se cilat janë arsyet që e kanë përzgjedhur, ç'mbresa u ka lënë, ç'kanë mësuar prej tij etj. Nxënësit e klasave të para e të dyta mund ta bëjnë shpjegimin me gojë, pasi atyre u duhet më tepër kohë për t'i shkruar mendimet ose nuk janë ende në gjendje për të shkruar.
2. Mësuesi u jep një model vlerësimi dhe secili nxënës e plotëson, pasi shton në dosje një punim të ri. Për nxënësit e klasave të para modeli mund të përmbajë qarkime, vizatime, grafikë të thjeshtë etj.

4. Diskutimi rreth punimeve dhe detyrave të portofolit

Diskutimet për punime të dosjes mund mësuesi mund t'i zhvillojë kokë më kokë me secilin nxënës, në çifte ose në grupet e punës në të cilat kanë punuar. Për të vendosur se si do të procedojë, mësuesi duhet të pyesë nxënësin, të marrë parasysh dhe t'i respektojë kërkesat e

tij. Në këto takime diskutimi, mësuesi dëgjon me vëmendje shpjegimet e nxënësve, i sheh portofolin me qetësi, e pyet për çështje të ndryshme dhe në fund i jep sugjerime sesi mund të vazhdojë më tej.

Është mirë që në këto takime të ftohen edhe prindërit. Ata duhet të përballen me punën, përpjekjet dhe mundësitë e fëmijës së tyre dhe të shohin se ku mund t'i ndihmojnë ata.

E megjithatë....

Përvoja e deritanishme ka treguar se del domosdoshmëri krijimi i dosjes së punës nga secili nxënës. Edhe në rastet kur në klasë nuk ka mundësi për t'i mbajtur dosjet, nuk ka dollapë ose nuk janë në gjendje të blejnë dosje, nxënësit mund t'i futin punimet në një kuti kartoni dhe t'i vendosin në parmakët e dritareve. Nxënësi mund ta mbajë dosjen në shtëpi dhe herë pas herë ta sjellë në shkollë për t'u parë nga mësuesi dhe shokët si është plotësuar.

KOMUNIKIMI I REZULTATEVE TEK PRINDËRIT

Në fillim të çdo viti akademik, mësuesi organizon një seancë informimi me prindërit, në të cilën u shpjegon mënyrën e vlerësimit të nxënësve, mënyrën se si do të organizohet ky vlerësim, ndihma që mund të japin prindërit, si dhe objektivat që priten të arrihen nëpërmjet realizimit të këtij vlerësimi. Pra, forma më e mirë për të informuar prindërit, dhe për të qenë në kontakt të vazhdueshëm me ta, është diskutimi në mënyrë të vazhdueshme në lidhje me atë çfarë kanë arritur apo po ndeshin vështirësi nxënësit. Gjatë takimeve mujore me prindërit, mësuesit u venë në dispozicion prindërve dosjen e fëmijës së tyre, duke dhënë edhe shpjegime, mbështetur në shënimet që ka mbajtur në fletorene tij. Gjithashtu, shihet e rëndësishme dhe e arsyeshme që nxënësit të jenë pjesë e këtyre diskutimeve përveç rasteve ku prindi dhe mësuesit mendojnë që duhet të flasin pa praninë e tij.

Është e këshillueshme që prindërit dhe mësuesit të realizojnë takime të përmuajshme, në mënyrë që t'u shpjegojnë prindërve arritjet e nxënësve. Ndërkohë mësuesit mund të kërkojnë takime të veçanta për nxënës të veçantë kur shohin që fëmija nuk realizon detyra të caktuara në lëndë të caktuara. Por, gjithashtu, edhe prindi ka të drejtën të kërkojë takime të posaçme kur konstaton që fëmija ka vështirësi në arritjen e rezultateve të të nxënës.

Orientime për prindërit për të ndihmuar fëmijët për të kaluar vështirësitë

Për nxënësit është shumë e rëndësishme që ata të marrin ndihmë të vazhdueshme nga prindërit gjatë kohës që realizojnë detyrat, punimet dhe projektet kurrikulare.

Disa pyetje prindërit duhet t'i kenë në qendër të vëmendjes gjatë kohës që ata kujdesen për ecurinë e fëmijës në shkollë:

- A mëson fëmija me dëshirë?
- A përqendrohet gjatë kryerjes së detyrave?
- A ka durim dhe përqendrim për të zgjidhur problemat dhe situatat komplekse?
- A e kupton menjëherë çfarë duhet të bëjë për realizimin e detyrës ?
- A i kushton rëndësi dhe kohë të mjaftueshme zgjidhjes së një detyre?
- A përpiqet për zgjidhjen e detyrave të vështira?
- A punon i pavarur?
- A punon me kujdes?
- A i bën detyrat pa e detyruar?

Këto pyetje prindërit duhet t'i diskutojnë me mësuesin, në mënyrë që të dyja palët të njohin më mirë fëmijën.

Hartimi i kësaj broshure u mbështet nga Save the Children

Save the Children

Rr “Komuna e Parisit” Lagjia 8, Pallatet 1 Maji, Vila “Lami” P.O. Box 8185, Tirane - Albania

Tel: +355 4 2261840/+355 4 2261929/+355 4 2266227; Fax: +355 4 2263428

Email: info.albania@savethechildren.org; web Page: albania.savethechildren.net

TIRANË, 2014

Ky botim publikohet në kuadër të projektit “Promovimi i të drejtës së fëmijeve për edukim dhe zhvillim tërësor” të organizatës Save the Children të zbatuar në marrëveshje me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.

© Të gjitha të drejtat të rezervuara. Përmbajtja e këtij dokumenti mund të përdoret apo kopjohet lirisht prej specialistëve të arsimit për zhvillim politikash dhe praktikash arsimore, por jo për qëllime fitimprurëse, me kusht që çdo riprodhim të shoqërohet me njohjen e të dy institucioneve si burim.

Këndvështrimet e autorëve të këtij botimi jo domosdoshmërisht pasqyrojnë pikëpamjet e “Save the Children”